



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
BASHKIA Durrës

Prot 883/1
dat 29.01.21

V E N D I M

Nr. 09, datë 29.01.2021

**“PËR MIRATIMIN E PLANIT TË DETYRUAR VENDOR PËR ZONËN E RE PËR
ZHVILLIM NË FSHATIN LALËZ, NJËSIA ADMINISTRATIVE ISHËM, BASHKIA
DURRËS”**

Në mbështetje të nenit 8, pika 2, neni 9, pika 1/1, shkronja”b” dhe nenit 23, pika 14 e Ligjit Nr. 139/2015 “Për vetëqeverisjen vendore”, Ligjit Nr. 97/2019 “Për miratimin e Aktit Normativ Nr. 9, datë 16.12.2019, të Këshillit të Ministrave, “Për përballimin e pasojave të fatkeqësisë natyrore”, të Ligjit Nr. 107/2014, datë 31.07.2014 “Për Planifikimin dhe Zhvillimin e Territorit”, i ndryshuar, të Vendimit Nr. 887, datë 24.12.2019 të Këshillit të Ministrave “Për përcaktimin e rregullave dhe procedurës së përshpejtuar për hartimin dhe miratimin e Planit të Detyruar Vendor, si dhe procedurës së miratimit të Lejeve të Zhvillimit/Ndërtimit, në rastet e fatkeqësisë natyrore”, i ndryshuar, të Vendimit Nr. 686, datë 22.11.2017 të Këshillit të Ministrave, “Për miratimin e Rregullores së Planifikimit të Territorit”, të ndryshuar, të Vendimit Nr. 561, datë 15.07.2020 të Këshillit të Ministrave “Për shpalljen e zonës së re për zhvillim në fshatin Lalëz, Njësia Administrative Ishëm, Bashkia Durrës”,

VENDOSA:

1. Miratimin e Planit të Detyruar Vendor për Zonën e Re për Zhvillim në fshatin Lalëz, Njësia Administrative Ishëm, Bashkia Durrës, në funksion të procesit të rindërtimit, sipas rregullave dhe procedurave të parashikuara në aktet normative në fuqi pjesë e të cilit janë dokumentet e mëposhtëm:
 - a) Dokumenti i Planit të Detyruar Vendor për Zonën e Re për Zhvillim në fshatin Lalëz, Njësia Administrative Ishëm, Bashkia Durrës;
 - b) Materiali hartografik
2. Ngarkohet Drejtoria e Planifikimit dhe Kontrollit të Zhvillimit të Territorit për botimin e të Detyruar Vendor për Zonën e Re për Zhvillim në fshatin Lalëz, Njësia Administrative Ishëm, Bashkia Durrës, në Regjistrin Kombëtar të Planifikimit të Territorit brenda 15 (pesëmbëdhjetë) ditëve nga data e miratimit të tij.

3. Ngarkohet Drejtoria e Planifikimit dhe Kontrollit të Zhvillimit të Territorit për ndjekjen dhe zbatimin e këtij vendimi.
4. Ky Vendim hyn në fuqi pas botimit në Regjistrin Kombëtar të Planifikimit të Territorit.

KRYETARI

EMIRIANA SAKO

